




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 29-09-2025
Nr. 5/3540

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesa nr. 5-3540 e datës 22.09.2025 e parashtruar nga BPrAL-Kolegji RIT Kosovo (A.U.K), nxjerr:

V E N D I M
Për rilicencimin e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K)

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) në Prishtinë, në nivel Institucional rilicencohet për periudhën pesëvjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030), sipas vendimit të AKA/s nr. 846/25, datë 10.07.2025.
2. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) në Prishtinë, rilicencohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA-s, nr. 968/25 datë: 01.08.2025, për programin e studimit;
 - 2.1. Studime Profesionale, MSC
3. Bartësi privat i arsimit të lartë/Kolegjit e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) në Prishtinë, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5-3540 të datës 22.09.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr. 846/25 datë: 10.07.2025 dhe vendimit nr. 968/25 datë: 01.08.2025

Komisioni vlerëson se parashtruesi i kërkesës Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për rilicencim. Rilicenca zgjat aq sa është paraparë në dispozitiv të këtij vendimi si në nivel institucional dhe të programit të studimit duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K);
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

